



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2020:001270

Datë: 12.06.2020

Numri i dokumentit: 00959266

P.nr.30/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJE DEGA NË I.. – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal, sipas Gjyqtarit të vetëm Gjykues, Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Hale Ahmetaj, në lëndën penale kundër të pandehurit A. Z. nga f.sh. S. , K. I.. , i akuzuar për veprë “vjedhje pylli” nga neni 349 par.2 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje – Departamenti i Përgjithshëm, me PP/II nr.2935/19 të datës 21.01.2020 në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.**09.06.2020**, në praninë e Prokurorit te Shtetit Suada Hamza, të pandehurit A. Z. , Gjykata të njëjtën ditë publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me dt.12.06.2020 përpiloje këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri, **A. Z.** i lindur me ne I.. , tani me banim ne f.sh. S. ,rr” G. i v.” K .I.. i biri i K. dhe nenës N. e gjinisë Q., i martuar, babai i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa pune, gjendjes se dobët ekonomike, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me nr....., Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, i dënuar me pare nga ana e gjykatës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë.09.11.2019, rreth ores15:30, ne vendin e quajtur “K.” Rajonin Ekonomiko Pyjor Mokna, i cili administrohet nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, zyra ne I.. i pandehuri me qellim te vjedhjes në pyllë, me sharre motorike ka prere 19 trungje te llojit te ahut me diametër prej 19-30 cm, me lartësi prej 18-21m, me vëllim përgjithshëm prej 9,50 m³, ne atë mënyrë qe ditën kritike shkon ne vendin e sipërshënuar dhe pasi i prenë drutë te njëjtat i ngarkon ne veturën e tij kombi te tipit M., ngjyre te k., me targa ...-....., ashtu qe Drejtoratit ne fjale i ka shkaktuar dëme materiale ne vlerë prej 1.216 (njëmijedyqindegjashtëmbëdhjetë) euro,

- me çka ka kryer veprën penale “vjedhje Pyllit” nga neni 349 par.2 te KPRK-së

Gjykata duke vendosur në kuptim të nenit 7,8,9,10,17,21,38,40,42,43,46,48,49,69,70, si dhe nenit 349 par.2 të KPRK-së, dhe nenit 359, 360, 361, 362, 365, 366 dhe 450 të KPRK-së,

E Gjykon me:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që:

1.Të pandehurit **A. Z.** , Gjykata i përcakton dënim me gjobe në shumë prej **500 (pesqind) euro**, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6(gjashtë)** muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afatin ligjor prej **1(një) viti**, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë të re penale.

2. I pandehuri lirohet në tersi nga shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor pasi që i njëjti është shfrytëzues i ndihmës sociale.

3.E dëmtuara DBPH- zyra në I... , për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritë aktakuzën, me PP./II nr.2935/19 të datës 21.01.2020, ndaj të pandehurit **A. Z.** nga f.sh. **S.** , **K.** I... , duke e akuzuar për veprë penale të vjedhjes së pyllit nga neni 349 par.2 te KPRK-së,

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 09.06.2020, ku kanë prezantuar Prokurori i shtetit, Suada Hamza, dhe i pandehuri **A. Z.** .

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, I pandehuri **A. Z.** deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, me vjen keq për rastin që me ka ndodhur, ju premtoj se në të ardhmen nuk do merrem me këso veprash penale, jetoj në gjendje të dobët ekonomike dhe atë nga ndihma sociale.

Prokurori i shtetit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë, i cili pranim ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe është bërë komfor dispozitave ligjore, propozoj gjykatës që të pandehurin të shpall fajtor për veprën e kryer dhe të dënoj sipas ligjit, si dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimin e fajësisë si dhe gjendjen e tij të dobët ekonomike të marr si rrethanë lehtësuese.

Pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit të prokurorit se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, pa asnjë presion. I pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 te KPRK-së janë përmbushur, Andaj Gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit **A. Z.** .

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit **A. Z.** është vërtetuar gjendja faktike se i njëjti më datë, 09.11.2019, rreth orës 15:30, në vendin e quajtur “K.” Rajonin Ekonomiko Pyjor Mokna, i cili administrohet nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi-zyra në I... , me qëllim të vjedhjes në pyllë, me sharre motorike ka prerë 19 trungje të llojit të ahut me diametër prej 19-30 cm, me lartësi prej 18-21m, me vëllim përgjithshëm prej 9,50 m³, në atë mënyrë që ditën kritike shkon në vendin e sipërshënuar dhe pasi i prenë trungjet ato ngarkon në veturën e tij kombi të tipit M., ngjyre të k., me targa, ashtu që Drejtoratit në fjale i ka shkaktuar dëme materiale në vlerë prej 1.216(njëmijedyqindegjashtëmbëdhjetë) euro,

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet veprën penale “vjedhje Pyllit” nga neni 349 par.2 të KPRK-së

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që i njëjti ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës, për veprën penale më të cilën është akuzuar.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së.

Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata gjeti faktin, se i pandehuri ka treguar sjellje korrekte në gjykatë, e për me tepër ka pranuar fajësinë duke shpreh edhe keqardhje për veprën që e ka kryer, jeton në gjendje të rëndë ekonomiko-sociale ku të ardhurat për familjen e tij tetë nataresh i siguron nga puna e krahut dhe ndihma sociale prej 125 euro në muaj, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të të pandehurit.

Rrethanë rënduese gjykata gjeti faktin se i pandehuri edhe me parë ka qenë i dënuar për vepra penale të ngjashme për të cilat është dënuar nga kjo Gjykatë sipas aktgjykimit të plotfuqishem me Pnr.256/12 i dt.18.11.2014, për vepra penale të vjedhjes së pyllit nga neni 358 par 2 të KPRK-së, është dënuar me burgim prej 6 muajsh dhe gjobë të kushtëzuar, me aktgjykimin me Pnr.858/13 i dt.21.06.2016, për vepër penale nga neni 252 par.1 të KPRK-së, është me dënim të kushtëzuar.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje të plotë me shkallën e përgjegjësisë penale të tij, si dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, po ashtu do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 453 par. 4 të KPRK-së, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta liroj nga pagesa e shpenzimeve procedurale dhe paushalli gjyqësore për faktin se është i papunë dhe i gjendjes shumë të vështirë ekonomike dhe shfrytëzues i ndihmës sociale, dhe si dëshmi për këtë ka ofruar kartelën e ndihmës sociale nga QPS në I... , me nr.regj..... Andaj çdo ngarkesë materiale kundër tij do të ishte shumë e rëndë për të dhe familjen e tij 8 anëtarësh.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontest civil është marrë konform nenit 463 par. 1. dhe 2. të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEGA I...

DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL
P.nr.30/20 më datë 09.06.2020

Sekretaria juridike

Hale Ahmetaj

Gjyqtari Gjykues

Arben Mustafaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Palët që në afatin ligjor kanë paralajmëruar ankesë kanë të drejtë që ankesën ta bëjnë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate